

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Nis sot viti i ri mësimor 2026-2027! 25 mijë fëmijë ulen për herë të parë në bankat e shkollës
ADRESA	https://piranjat.al/aktualitet/nis-sot-viti-i-ri-mesimor-2026-2027-25-mije-femije-ulen-p-er-here-te-p-i103984
BURIMI	piranjat.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	14 shtator 2026, 06:45:49 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	14 shtator 2026, 06:42:51 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	2d712abc0c06375d3f5f4c7f3d638fa1d9bee172e1aee58f03fd0549050de902
TEKSTI	f455c1f150be16c7ede9c2f6e48e138a3d3bce854463721af73ba656cab00396
PAMJA	2668ce1ec77a9bf5dd7645159232aae4ba905ca63ccb95ceef8202d4bde43709

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	408afb4ad78607d66e16fec868578aa67dd9d4211054b73c3f068acd4359e39
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	7f30966000672975708e7c492689d739f9d4667f12adc4270686e28ed502fc27
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/408afb4ad78607d66e16fec868578aa67dd9d4211054b73c3f068acd4359e39>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [EDITORIAL](#)
- [EMISIONE](#)
- [INVESTIGIME](#)
- [AKTUALITET](#)
- [SOCIALE](#)
- [POLITIKË](#)
- [KOSOVA](#)
- [BOTA](#)
- [SHOWBIZ](#)
- [LIFESTYLE](#)
- [SPORT](#)

[SYRI LIVE](#)



Flash:

vjenrrin, shpallet në kërkim

ne Roskovec, ku një person

qytetarë në shesh: Rama ien

rrabë, ndërsa aksioni qytetar

e plagos me çekiç! Në kërkim autori

Roskovec, ku një shtetas dëshrohet se

shqiptarët, në Gjermani

serish me ritme të larta në 10 vitet e

temperaturat

pritet të shkojnë deri në 31&de...

AKTUALITET

Nis sot viti i ri mësimor 2026-2027! 25 mijë fëmijë ulen për herë të parë në bankat e shkollës

Piranjat Përditësimi i fundit 14 Shtator 2026, 08:42



Në të gjitha shkollat e vendit nis sot viti i ri mësimor, ditë me emocione sidomos për 25 mijë fëmijët që ulen për herë të parë në bankat e shkollës.

Ky vit i ri shkollor 2026-2027 vjen me risi dhe investime të rëndësishme në institucionet arsimore.

Në ditën e parë të vitit të ri shkollor në të gjithë vendin kanë hapur dyert rreth 42 shkolla të reja dhe terrene sportive, ndërsa vetëm në Tiranë janë ndërtuar 8 shkolla të reja, duke krijuar më shumë mundësi që fëmijët të mësojnë dhe të zhvillohen në ambiente moderne, të sigurta dhe me standarde europiane.

MAS në të gjitha shkollat e vendit ka shpërndarë tekstet shkollore për vitin e ri shkollor, ndërsa për herë të parë, i gjithë cikli i arsimit fillor, nga klasa e parë deri në klasën e pestë, është pajisur me tekste shkollore të reja dhe falas.

Për herë të parë 408 shkolla në mbarë vendin janë pjesë e programit "Pas shkolle", duke u krijuar nxënësve mundësi për të mësuar, argëtuar dhe zhvilluar talentet e tyre në një mjedis socializimi dhe edukimi.

Programi përfshin disa fusha, ndër të cilat "Bëjmë detyrat e shtëpisë", muzikë, teatër, kërcim, zeje dhe arte pamore.

Përmes këtyre aktiviteteve synohet që nxënësit të kenë akses në orë cilësore pas mësimi, të zhvillojnë potencialin dhe aftësitë e tyre, si dhe të krijojnë më shumë mundësi për socializim.

Sa i përket orareve, fëmijët e klasave të para dhe të dyta që mbarojnë mësimin në 11:30 do të qëndrojnë në shkollë deri në orën 14:00, ndërsa ata që përfundojnë në orën 12:30 ose 13:10 do të mund të qëndrojnë deri në orën 15:00.

Një nga risitë më të rëndësishme të udhëzimit për vitin e ri shkollor 2026-2027 lidhet me mënyrën e organizimit të ditës së parë të shkollës në të gjitha institucionet arsimore parauniversitare.

Dita e parë e shkollës do t'i kushtohet veçanërisht orientimit dhe informimit të nxënësve, duke i njohur ata me rregullat, normat e sjelljes dhe mënyrën e organizimit të institucionit arsimor.

Gjithashtu këtë vit shkollor sipas udhëzuesit të hartuar nga ministria e Arsimit dhe të publikuar nga Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar inteligjenca artificiale do të mund të përdoret si një mjet mbështetës në procesin mësimor.

Dokumenti përcakton mënyrat se si mësuesit dhe nxënësit mund të përdorin mjete të inteligjencës artificiale, përfshirë platforma si ChatGPT, Gemini dhe mjete për verifikimin e informacionit, me synimin që teknologjia të ndihmojë zhvillimin e aftësive njerëzore dhe jo t'i zëvendësojë ato.

Siguria në shkolla mbetet një tjetër prioritet i këtij viti, ku 20 shkolla të Tiranës dhe Kamzës janë pajisur me kamera inteligjente në kuadër të projektit "Smart City".

Artikuj te sugjeruar

AKTUALITET 14 Shtator08:32

Dyshohet se plagosi me çekiq ish-vjehrrin, shpallet në kërkim daja i deputetes Zegjine Çaushi

Një ngjarje e rëndë ka ndodhur mbrëmjen e djeshme në Roskovec, ku një person plagosi me çekiq ish-vjehrrin e ...

AKTUALITET 14 Shtator08:10

Vajza e saj 10 muajshe ishte me temperaturë/ Gazetarja rrëfen eksperiencën në QSUT-së: Prindërit përballen me arrogancë dhe poshtërim

Gazetarja Bora Shahini ka rrëfyer eksperiencën e saj në Pediatrinë e QSUT-së, pas një rasti që kishte të bënte me...

AKTUALITET 14 Shtator07:58

“Nuk e kuptoj çfarë përbindëshash jeni”/ Letra e Nazmi Berishës nga Burreli për Mehmet Shehun, dëshmia që rrëzon mitin komunist të “atdheut mëmë”

Ka dokumente që nuk kanë nevojë për shumë koment. Mjafton t'i lexosh fjalët dhe e kupton menjëherë se çfa...

AKTUALITET 14 Shtator07:54

AKEP ndalon klauzolat e indeksimit, rritja e çmimit të celularëve duhet të parashikohet në vlerë

Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP) do të ndalojë aplikimin e klauzolave të ndryshimit të tarifave, të shprehura...

AKTUALITET 14 Shtator07:46

Sherr me babain e ish-bashkëjetueses, e plagos me çekiq! Në kërkim autori

Një plagosje ka ndodhur mbrëmjen e djeshme në fshatin Suk të Roskovecit, ku një shtetas dyshohet se është goditur me &ccedi...

AKTUALITET 14 Shtator07:38

Emigracioni/ BE ka dhënë 1.1 milionë leje qëndrimi për shqiptarët, në Gjermani numri arrin rekordin e 124 mijë

Emigracioni i shqiptarëve drejt Bashkimit Europian ka mbetur sërish me ritme të larta në 10 vitet e fundit, dhe gradualisht po tejkalon va...

AKTUALITET 14 Shtator07:20

Njihuni me parashikimin e motit për sot, ja sa do të jenë temperaturat

Moti do të jetë i qëndrueshëm gjatë ditës së sotme, ndërsa temperaturat pritet të shkojnë deri në 31&de...

AKTUALITET 13 Shtator23:18

Të shtëna me armë pranë një lokali në Greqi, dyshohet se është i përfshirë Alket Rizai

Shqiptari Alket Rizai, ish-bashkëpunëtor i të shumëkërkuarit grek Vasilis Paleokostas dhe i njohur për arratisjen dy herë m...

AKTUALITET 13 Shtator23:04

E rëndë në Patos, një person gjendet i pa jetë në oborrin e banesës

Një ngjarje e rëndë ka ndodhur pak më parë në Patos. Një person është gjetur i pa jetë në oborrin e bane...

AKTUALITET 13 Shtator22:16

“Rama na preu në besë”/ Dita e 45-së e protestës, Divjaka kundër Territoriales: Nuk pranojmë të bashkohemi me Lushnjen

Divjaka vijon protestën kundra projektit të PS për shkrirjen e bashkisë dhe kalimin në varësi të Lushnjes. Identiteti, hist...

ME TE VIZITUARAT

BOTA 13 Shtator

"Kaos" në fluturimin Australi-Katar/ Dy burra p...

Një incident është regjistruar në bordin e një fluturimi nga Melbourne drejt Dohas, ku dy pasagjerë meshkuj u bënë agre...

AKTUALITET 13 Shtator

“Dil jashtë”, u përplas me Edi Ramën për “Terri...

Mes debateve dhe përplasjeve, kështu është zhvilluar mbledhja e kësaj të diele mes kryeministrit Edi Rama dhe komunitetit të...

[A mund t'i mbijetojë tregu i naftës një lufte t...](#)


Lufta mes SHBA-së dhe Iranit ka zgjatur shumë më tepër nga sa pritej, por pavarësisht tronditjeve, tregu global i naftës ka tregua...

INVESTIGIME 31 Maj14:01

[Gratteri për Piranjat: Kam 38 vite që më duan të vdekur ndaj nuk dal kurrë në publik](#)


Për më shumë se tre dekada, jeta e kryeprokurorit italian të antimafias, Nicola Gratteri, ka qenë nën hijen e kërcënimev...

video



Reagon Cllevio!





Reagon Clevio!



Matilda, Piranja jonë vegjetariane: gjatë javës kap të korruptuarit, të dielën thyen rekorde në male!





Deklarata e Gjestit!



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.